

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E HËNË 6 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë shqiptarë,

Në fakt, sot po diskutojmë për disa problematika në zonat tona. Pak ditë më parë mjaftuan disa minuta shi që të përmyteshin disa rrugë e lagje të qytetit të Lezhës, si: “Besëlidhja”, “11 Janari” dhe 11,2 hektarë tokë. Përgjatë bulevardit “Gjergj Fishta” uji vërshoi në disa biznese, duke shkaktuar dëme të mëdha. Është e patolerueshme që kjo situatë nuk gjen zgjidhje sot që flasim, kur i gjithë pushteti është në duart e socialisteve dhe nuk kanë asnjë pengesë për t’i zgjidhur këto shqetësime të mijëra banorëve të qytetit të Lezhës, në një kohë kur vëmendja po përqendrohet te disa investime në fasada, të cilat jo se nuk janë të mirëpritura, por një përparësi më të madhe kanë punët e rëndësishme.

Situata ekonomike është tejet alarmante dhe shqetësuese. Lezha është një nga qarqet me varfërinë më të madhe në Shqipëri dhe sot po përballet me rritjen e çmimeve, si të ishte qarku më i pasur. Kjo situatë e ka rënduar edhe më shumë gjendjen ekonomike të qindra familjeve në zonat më të varfra, si në fshatrat e njësive administrative Ungrej, Dajç, Balldren, Shënkoll e të tjera. Situata tejet të vështirë po kalojnë familjet me ndihmë ekonomike dhe pensionistet e Lezhës. Sfidoj sot çdo deputet të pushtetit që të shkojë në disa dyqane ushqimore në të katra anët e Lezhës që të shohin me sytë e tyre listat e verësies, ku familje të nderuara lezhjane marrin ushqime me listë, në pamundësi për t’i paguar ato, të cilat marrin me listë bukën e përditshme, marrin me listë vajin që kushton 400 lekë/litri; të mos flasim pastaj për ushqimet e tjera të shportës.

Po ashtu, problematike shfaqet gjendja në bujqësi, ku 60% e popullsisë jeton në fshat, merren me bujqësi e blegtori. Propaganda e Edi Ramës për mbështetjen e fermerëve kthehet përmbys, po të shikosh sipërfaqet e tokave në të gjithë territorin e Lezhës. Fusha e Zadrimës, ajo e

Torovicës, e Bregut të Matës dëshmojnë qartë gjendjen e vështirë, pasi prodhojnë pak e aspak dhe pjesa më e madhe e tyre është lënë djerrë, pasi shteti inekzistent nuk i mbështet fermerët. Si mund të pretendohet që ndihmohen fermerët, në një kohë kur çmimi i naftës nga bordi i Ramës vendoset afro 250 lekë/litri?

Të nderuar kolegë,

Realiteti sot në Lezhë nuk është ai që reklamohet në ekranet e televizioneve, që kontrollohen nga pushteti i Ramës. Rritjen e çmimeve qeveria juaj e justifikon me rritjen e çmimit të naftës dhe rritjen e naftës ia faturon luftës në Ukrainë. Atëherë lind pyetja: çfarë mirëqenieje ka arritur kjo qeveri për popullin e saj, ku çdo dështim e lidh me luftën në Ukrainë, me tërmetin dhe me pasojat post-COVID? Por ka edhe disa pyetje të tjera pa përgjigje: pse Kosova e Maqedonia e kane çmimin e naftës me të lirë dhe jo pak, por 400 lekë/litri me lirë? Madje, jo vetëm çmimin e naftës, por në tërësi të gjitha çmimet e shportës i kanë më të lira çmimet. A nuk i prek edhe ato kriza ndërkombëtare, apo vetëm Shqipërinë e prek kjo krizë? Shikojini qytetarët e qarqeve kufitare.

Në qarkun e Kukësit qytetarët nga Tropoja, Kukësi dhe Hasi shpesh dalin dhe blejnë në Prizren e në Gjakovë. Dibra blen në Dibrën të Madhe. Në qarkun e Korçës qytetarët e Pogradecit e Korçës blejnë dhe furnizohen në Maqedoni dhe në Greqi, por kudo çmimet janë më të lira se sa në Shqipëri. Kalojmë pak edhe tek turizmi. Lezha ka territor të jashtëzakonshëm dhe është një ndër zonat më të bukura që vizitohet nga turistë të shumtë gjatë gjithë vitit. Turizmi nuk është vetëm fasadë, por është edhe funksionalitet. Dështimi juaj në këtë drejtim është lehtësisht i prekshëm. Trafiku, që nis nga Miloti në Shëngjin, është fytyra e pritjes së turistëve. Pushuesve nga Kosova, dhe jo vetëm, gjatë verës u duhen edhe 2 orë të tjera për të përshkuar rrugën nga Miloti në plazhet e Shëngjinit dhe të Tales. Zgjidhja me patrulla policore është shërbimi i mirëseardhjes.

Të dashur qytetarë, të flasësh për problematikat e Lezhës nuk mjaftojnë 4 minuta, pasi të gjithë e dimë që jetesa në Lezhë dhe në Shqipëri po bëhet gjithnjë edhe më e pashpresë, sepse të ardhmen e ka vuarë pushteti absolut që mendon për puthadorët afër vetes. Ndaj ikën rinia, se këtij vendi ju i keni vuarë shpresën, por ikja nuk është zgjidhje, por përballja me keqqeverisjen

tuaj është detyrë jo vetëm e çdo demokrati, por e çdo shqiptari për t'i dhënë Shqipërisë të ardhmen që meriton: rrugën e shpresës dhe të besimit. Faleminderit!